



Komuna e Klinës

Zyra e kryetarit

01Nr. M-2090/2024

Klinë, datë 12/07/2024

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 8 të Rregullores së QRK-së nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtareve Publik, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës, më qellim të ofrimit të shërbimeve bashkatdhetarëve gjate sezonit veror, kryetari i komunës merr **këtë**:

## V E N D I M

Për ofrim të shërbimeve të gjendjes civile deri në orën 18:00

1. Zgjatet orari i punës i zyrës së gjendjes civile në Klinë, dhe atë ditëve të punës nga ora **16:00** deri ne orën **18:00**, nga data 15.07.2024 deri më datën 30.08.2024.
2. Obligohet Drejtoria e Administratës në bashkepunim më udhëheqësin e sektorit të gjendjes civile te organizoj kryerjen e shërbimeve te gjendjes civile për kohen dhe periudhën e lartcekur përmes zyrtareve përgjegjës ne përputhje me dispozitat ligjore për pune jashtë orarit te punës.
3. Për zbatimin e ketij vendimi kujdeset Drejtoria e Administratës në bashkepunim më udhëheqësin e sektorit të gjendjes civile.
4. Arsyeja e nxjerrjes se ketij vendimi behet më qellim te ofrimit te shërbimeve fluksit të bashkatdhetarëve gjate sezonit të pushimeve verore.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Drejtoria e Administratës;
- Udhëheqësi i gjendjes civile;
- Zyra e informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,  
Zenun Elezaj

